REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 458/20
Datë/Datum. 09.07.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Komuna e Gjakoves

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 632-20-3153-1-2-1

Sa i përket tenderit për Furnizim me paisje te instrumentit GPS dhe Total Station

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

DWH-KOSOVA SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Hilmi Rakovica 13
(Adresa)
Prishtine — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*
+37744779379 — *N/A*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Selvete Gagica
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
Leta.gagica@dwh-solution.com
(Adresa elektronike)

~~*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*~~

~~*(Adresa)*~~

~~*(Vendi)*~~ ~~*(Kodi postar)*~~

~~*(Numri Telefonit)*~~ ~~*(Numri i Faks-it)*~~

~~*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*~~

~~*(Adresa elektronike)*~~

09.07.2020 DWH – KOSOVA shpk

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

26.06.2020 – Njoftimi per Kontrat 29.06.2020 – Kerkes per informacione shtes 06.07.2020 – Pergjigja e AK ndaj kerkeses per informacione shtes 06.07.2020 – Kerkesa per Rishqrytim 09.07.2020 – Refuzimi i Kerkeses per Rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒ *x*

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ Jo ☒

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji i prokurimeve publike 04/L-042, i ndryshuar dhe perplotesuar me ligjet 04/L-237, 05/L-068 dhe 05/L-92 Neni 1, P. 1, 2 dhe 3 Neni 7, P. 1, 2, 3, 4 dhe 6 Neni 9, P. 1 Neni 10, P. 1, 2 dhe 3 Neni 28, P 1, 2, 2, 3, 4, 6, 7, 8 dhe 9

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PARAQITJA FAKTIKE

AK, KKGJ ne vazhden e tenderave te meparshem - si edhe i referohet vehte ne refuzimin e kerkeses tone per rishqyrtim - ka manipuluar specifikimet teknike te kerkeses, qe te perjashtoje me vone te gjithe ofertuesit dhe ti hape rruge Topcon-Sokkia, i cili eshte edhe GPS me performancen me te dobet ne kategorine e kerkuar.

AK ben nje AUTODENONCIM TE HATASHEM, kur shkruan qe:
"Specifikimet teknike nuk jane marre nga nje datasheet (broshure), por eshte bere nje permbledhje e specifikimeve baze *per ti cuar kompanite konkurruese ne prodhimin e fundit te tyre"*

Ne nje shtet te se drejtes do mjaftonte ky fakt i pranuar dhe vetdenoncuar per te kuptuar qe tenderi eshte manipuluar per interesa ne kundershtim me interesin publik.

Ne nje shtet te se drejtes punonjesi apo punonjesit publik, qe kane pasur detyre te merren me dosjen nuk do te ishin ne kete moment duke u perballur me OSHP, por me nje tjeter gjykate.

E nderuar OSHP, paisja gjeodezike qe AK kerkon te bleje eshte 1 nga mbi 100 qe ofron tregu boteror, dhe per nga kualiteti dhe performanca produkti i parazgjedhur nga keta, i njejti qe kane tentuar ketu e dy vjet (hap e mbyll tender), eshte ne nivelin basic (pra nga me te dobtit) dhe nga me te liret ne cmim, sa qe nuk shkojne as ne 1/2 e buxhetit te kalkuluar nga AK.

Disa spiegime per njerez jashte fushes se gjeodezise (ndoshta edhe per Ekspertin Shqyrtues, nese nuk do jete i fushes).

Produkti 1: GPS
GPS perbehet nga:
- Antenna + Marresi (qe jane ne nje trup te vetem),
- Softweri gjeodezik i punes
- Kontrolleri, qe lexon te dhenat

Le ti marrim me rradhe:
Pjesa e pare dhe me e rendesishme (80%) e paisjes eshte: Antenna/Marresi.
AK nuk ka vendosur asnje specifikim perjashtues, praktikisht kerkesa eshte "0"?!
Aresyeja, sepse Antenna/Marresi i parazgjedhur eshte me specifikime te pamjaftueshme, nese "NIVELI" i kerkeses do ngrihej pak fare, ky produkt nuk i ploteson.

Arritjete e fundit te GPS (pra bashkohoret) punojne:
1. ne pjerresi >20grad
Te gjithe GPS e kesaj kategorie punojne mbi 20grad.
I vetmi GPS qe punon nen 15grad eshte ky i kerkuari, dhe AK cfare ben e ul kerkesen ne "10grad". Kjo kerkese eshte pa kuptim se nen 10 grad nuk ka asnje GPS.

2. Sinjalet e reja satelitore shtrihen ne frekuencen e trete
GPS L5
Glonass L3
Galileo E6
BDS B3

Cfare kerkon AK, asgje nga keto!!! Pse? Sepse GPS kerkuar nuk kap as L3, as E6, dhe as B3.

Me kaq mbaron kerkesa e AK per GPS. Pra per GPS nuk ka gare, mund te ofroje kushdo.

Pjesa e dyte e paisjes (15%) eshte: Software-i gjeodezik i punes, qe i nevoitet gjeodetit per pune.

AK per kete nuk ka asnje kerkese. Pra se ofrohet software apo jo nuk i intereson AK. Pra kerkesa eshte "0".
Pse? Spese produkti i parazgjedhur eshte nen gjithe software-t e konkurences.

Pjesa e trete (5%) e piasjes eshte: Kontrolleri.

Kontrolleri eshte nje paisje telefonike, i cili ka dy funksione te thjeshta:
1. te lidhet me internetin, dhe
2. te lexoje te dhenat e Antenes/Marresit

Kurse per AK, kjo pjese eshte 100% e paisjes, sepse vetem ketu ka vendosur kerkesa nga me te habitshmet.
Ketu AK fillon te dancoje Rrock, Pop, Volk etj ne menyre te perzjere.

Ti marrim me rradhe:
1. AK shkruan "Kontroller", por ne te vertete pas kontrollerit pritet "iPAD"
Kurthi 1, cfare interesi ka AK qe mos te shkruaje iPAD, nese ka kerkuar iPAD?

2. AK kerkon Windows
Kurthi 2, perse AK perjashton 99% te garuesve, sepse dihet qe 99% e pasijeve telefonike (Celular dhe iPAD) jane Android dhe IOS?

Kujtojme ketu, qe AK nuk ka bere asnje kerkese per Software-in gjeodezik?!?!?!

3. AK kerkon qe kontrolleri (iPAD) te kete 6GB.
Kurthi 3, 6GB kerkohet qe ti hap rruge produktit te kerkuar qe ka 8GB.

4. AK kerkon qe Kontrolleri (iPAD) te kete memorje 64GB
Kurthi 4, perse nuk thote qe memorja te jete e brendshme e iPAD, nese po cilin ka

pasur parasysh?

Pra si edhe shihet e gjithe kerkesa eshte te kontrolleri (te i cili fshihet nje iPAD i cuditshem me windows, 6GB dhe 64GB memorje), kurse GPS dhe Software-i punes ska fare rendesi.

Si spiegohet qe AK deri dje kerkonte mbi 225 kanale (pra faktikisht 226) o ska tjeter, te cilat te conin tek po ky produkt?
Tani qe ky produkt eshte i vetmi me 226 kanale (produkt bashkohor?!), se te gjithe te tjeret ofrojne mbi 300 kanale, ata leshojne kanalet dhe hidhen nga antena te kontrolleri?

E nderuar OSHP, AK nuk e ka parasysh, qe
1. eshte e detyruar me LIGJ te siguroje pjesmarrje sa me te gjere.
2. eshte e detyruar me LIGJ te beje me dije burimin se ku gjenden specifikimet e kerkuara
3. eshte e detyruar me ligj te shkruaje EKUIVALENTE, qe te hap garen.
4. eshte e detyruar me ligj te heqe specifikimet qe ngushtojne garen
5. eshte e deytruar me ligj te zbatoje vendimet e OSHP, e cila ne tenderet e meparshem ka kerkuar te vendoset tek WINDOWS edhe EKUIVALENTE.

Ne i kujtojme OSHP, qe AK per vendime te te njejtes kerkese ne tenderat e meparshem, eshte prapsuar mbi pese here nga OSHP, dhe ajo me kokfortesi ka refuzuar te zbatoje vendimet e OSHP, duke i cuar tenderat ne anullim. Nese KKGJ ka nevoje per pasijet e kerkuara, demet duhet te jene te pallogaritshme duke shtyre blerjen e tyre me vite.

Nese AK kerkon te bleje me parazgjedhje, atehere le te ndjeke rrugen e "prokurimit nje-burimor", qe e pranon edhe ligja.
Nese AK kerkon te bleje "de facto ne menyre nje-burimore" dhe "de jure me tender", atehere dicka nuk shkon, sepse ligjvenesi me vetdije te plote nuk ka lejuar nje mundesi te trete.

I kerkojme OSHP, te vendose kete tender ne shtratin ligjor.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*